



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 21.01.2020

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8402,
DATE 10.9.1998, “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, në mbledhjen e datës 21 janar 2020.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputeten Eglantina Gjermeni relatore për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishte Z. Artan Shkreli, Zëvendësministër në ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësues të kësaj ministrie, si dhe drejtori i Institutit të Ndërtimit. Z. Agron Hysenlliu

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Ky projektligj është një nismë e Këshillit të Ministrave, i propozuar në Kuvend në datën 28 tetor 2019. Projektligji është iniciuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të situatës

së krijuar nga dëmtimet që shkaktoi tërmeti i datës 21 shtator 2019 në disa qytete të vendit, për t'iu përgjigjur nevojës së menjëhershme për ndërtimin e riparimin e ndërtesave të dëmtuara.

Ndryshimet e propozuara synojnë: zëvendësimin e disa termave në ligj, me qëllim harmonizimin me legjislacionin për planifikimin e territorit; shtimin e një neni i cili vendos detyrimin për kryerjen e procesit të auditimit teknik në të gjitha objektet të cilat janë ndërtuar prej mbi 50 vjetësh, sipas rregullave dhe mënyrës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave; riformulimin e nenit që përcakton mënyrën e kryerjes së opionencës teknike, duke përcaktuar se ajo do të kryhet nga institucionet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha ndërtimet publike, ndërtimet jopublike me vlerë të preventuar, së paku, 100 milion lekë, dhe objektet me akses publik, të tilla si kinema, teatro, stadione etj.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

- ***Diskutimi në Komision***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar”, është shqyrtuar nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21 janar 2020.

Relatorja, Znj Gjermani, shpjegoi qëllimin e projektligjit dhe çfarë synojnë ndryshimet e propozuara dhe theksoi rëndësinë që ai paraqet, lidhur me nevojën për disiplinimin e ndërtimeve, të evidentuar në kuadër të situatave të vështira që kaloi vendi pas dy tërmeteve, të shtatorit dhe nëntorit, të vitit 2019.

Znj. Gjermani adresoi disa pyetje për propozuesit e projektligjit, lidhur me nevojën për ta plotësuar projektligjin me parashikime të tjera në reflektim të ndryshimeve të ndodhura edhe pas tërmetit të nëntorit 2019, si dhe nevojën për harmonizimin me ndryshimet e miratuara me Aktin Normativ për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, të miratuara në Kuvend në dhjetor 2019, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave për sigurimin e banesave.

Përfaqësuesit e ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u shprehën se qëllimi kryesor i ndryshimeve të propozuara është futja e dy elementëve të rinj: atij të certifikimit dhe të garancisë së objekteve që kanë një kohë të gjatë përdorimi, mbi 50 vjet, me qëllim vlerësimin e cilësisë së materialeve të ndërtimit të përdorura dhe të ndërhyrjeve në strukturë, të bëra nga vet njerëzit, si dhe zgjerimi kategorisë së objekteve, projektet e ndërtimit të të cilave do t'i nështrohen kryerjes së

oponencës teknike. Këto ndryshime i përgjigjen dhe adresojnë edhe problematikat më emergjente të evidentuara pas tërmetit të nëntorit, si dhe janë në përputhje me ndryshimet ligjore dhe nënligjore të miratuara së fundmi.

Gjatë shqyrtimit në parim, diskutimet e anëtarëve të komisionit dhe pyetjet drejtuar propozuesve konsistojnë kryesisht në procesin e auditimit teknik: çfarë nënkupton ky proces; cilët do të jenë subjektet që do të kryejnë atë; nëse do të jetë kjo një veprimtari e licencuar; kriteret mbi të cilat është vendosur afati 50 vjeçar; nëse ka ndonjë afat të përcaktuar për fillimin dhe përfundimin e procesit të auditimit teknik të ndërtesave; nëse do të jetë një proces kalimtar apo i vazhdueshëm.

Përfaqësuesit e ministrisë shpjeguan se thelbi i procesit të auditimit teknik është verifikimi i gjendjes teknike të ndërtesave. Ky është një proces, në thelb, i njëjtë me atë të oponencës teknike, i cili është i parashikuar në ligjin ekzistues, me ndryshimin se procesi i auditimit teknik kryhet mbi ndërtesat, duke vlerësuar gjendjen e tyre teknike, ndërsa procesi i oponencës teknike kryhet në fazën e projektimit të objektit.

Procesi i auditimit do të jetë një proces i vazhdueshëm, i cili në mënyrë periodike dhe programatike do të zhvillohet, në bazë të planeve të detajuara, në çdo bashki, duke nisur me objektet publike: shkolla, kopshte, për të vijuar me objektet me akses publik, merkato, kinema etj. Rezultatet e auditimit do të jenë detyruese, për t'i përshtatur ndërtesat me kërkesat sizmike. Do të jetë Këshilli i Ministrave që nëpërmjet një vendimi do të përcaktojë rregullat dhe mënyrën se si do të kryhet procesi i auditimit dhe cilat do të jenë subjektet që do ta kryejnë atë.

Lidhur me kriteret për përcaktimin e afatit prej 50 vitesh, propozuesit sqaruan se ai është vendosur bazuar në afatet teknike të degradimit të elementeve përbërës të materialeve të ndërtimit (betonit dhe hekurit), siç përcaktohet edhe në Eurokodet.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, relatorja propozoi nevojën për përfshirjen në projektligj të një përkufizimi të auditimit teknik, pasi nuk del qartë natyra e këtij procesi. Për këtë qëllim, propozoi shtimin e tij si një paragraf i dytë në nenin 4/1 të ligjit, i cili ndryshohet nëpërmjet nenit 2 të projektligjit.

Gjithashtu, deputeti Ilir Beqaj, propozoi përfshirjen në projektligj të një dispozite për përcaktimin e përgjegjësive për shpërblimin e dëmeve që mund t'i shkaktohen veprës gjatë fazës së ndërtimit, përgjegjësisë ndaj të tretëve në këtë rast.

- ***Ndryshime të projektaktit dhe propozime për ndryshim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi, në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni, miratoi ndryshimet si vijon:

1. Në nenin 2 të projektligjit, që shton nenin 4/1 në ligj, të shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Me “auditim teknik” kuptohet akt ekspertiza e thelluar që vlerëson gjendjen teknike të një objekti dhe kapacitetet e tij mbajtëse.”

2. Pas nenit 3 të projektligjit, të shtohet neni 3/1 dhe 3/2 me përmbajtje si vijon:

“Neni 3/1

“Për të gjitha ndërtimet me vlerë mbi 100 milion lekë, zhvilluesi kryen dhe mban në fuqi, për të gjithë kohën e ndërtimit të objektit, sigurimin e detyrueshëm nga rreziqet për punimet e ndërtimit. Elementët e sigurimit të detyrueshëm dhe rregullat e sigurimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 3/2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 2, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe aktin nënligjor në zbatim të nenit 4, brenda 10 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.”

RELATORE

Eglantina Gjermeni

KRYETAR

Niko PELESHI